



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.325/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit S. T., për shkak të veprës penale krime lufte kundër popullsisë civile nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, paraparë edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, krime të luftës në shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës nga neni 144 të KPRK-së, veprës penale krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3, të përbashkët për katër konventat e Gjenevës nga neni 145 dhe 146 të KPRK-së dhe organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës nga neni 154, ndërlidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PPPS.nr.64/2022 të datës 24.05.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, PN.1.S.nr.93/2023 të datës 05.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit S. T., të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PPPS.nr.64/2022 të datës 24.05.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, PN.1.S.nr.93/2023 të datës 05.06.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PPPS.nr.64/2022 e datës 24.05.2023, të pandehurit S. T., për shkak të veprës penale krime lufte kundër popullsisë civile nga neni 142, lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, paraparë edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, krime të luftës në shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës nga neni 144 të KPRK-së, veprës penale krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3, të përbashkët për katër konventat e Gjenevës nga neni 145 dhe 146 të KPRK-së dhe organizimi i grupeve për

kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës nga neni 154, ndërlidhur me nenin 31 të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi i është vazhduar deri më datë 15.07.2023. Të pandehurit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1., e 1.2., pikat 1.2.1.dhe 1.2.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN.1.S.nr.93/2023 të datës 05.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit S. T., avokati Dejan Vasiq nga M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara me nenin 432, paragrafi 1, nën-pika 1.2. të KPP-së, konkretisht nenin 384, paragrafi 2., pika 1.10. dhe 1.3 të KPP-së, nenit 171, paragrafi 2. të KPP-së, 404, paragrafin 1. të KPP-së dhe nenit 475, paragrafi 1. të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'ia ndërprënë paraburgimin të pandehurit, apo të shqiptojë një masë alternative më të butë ose të anuloj aktvendimet e atakuara dhe lëndën ta kthejë në rigjykim tek gjykata e shkallës së parë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.135/2023 e datës 06.07.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, thekson se me aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë të pandehurit i vazhdohet paraburgimi në bazë të provave plotësisht të jashtëligjshme, se vetëm pasi që lënda është kthyer në rivendosje nga gjykata e shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë ka thirrur prokuroren speciale për të paraqitur provat të cilat mbështesin pretendimet se saja, ashtu që për herë të parë ka dorëzuar prova gjashtë muaj pas paraburgimit të pandehurit, se arsyetimi për rrezikun e ikjes paraqet një diskriminim të popullit serb, ndërsa nga ana tjetër nga praktika gjyqësore në Kosovë, ka një numër të caktuar të rasteve ku për vepra penale të njëjta, prezenca e të pandehurve në procedurë është siguruar me masa alternative më të buta ose iu është lejuar që të mbrohen në liri, ndërsa sa i përket rrezikut të ndikimit në dëshmitarë, ky rrezik është absolutisht inekzistentë madje është e pakuptimtë të mendohet se një ndikim i tillë është i mundur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se ekziston dyshimi i

bazuar se i pandehuri S. T. gjatë periudhës kohore të vitit 1998-1999, saktësisht me datën 06.04.1999, në fshatin R. Komuna e V. së bashku me pjesëtar tjerë ende të pa identifikuar, si pjesëtarë i forcave policore dhe ushtarake serbe ka qenë i përfshirë në keqtrajtimin, maltretimin, plaçkitjen, si dhe vrasjen e personave civil dhe shpërnguljen me dhunë nga shtëpitë e tyre gjatë kohës së luftës, ka shkelur rëndë rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, kundër personave civil dhe pasurisë nga neni 3, paragrafi 1. shkronja (a), (b) dhe (c) të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12.08.1949 dhe Protokollet shtesë, si dhe provat tjera materiale, andaj rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat tjera të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, për vazhdimin e paraburgimit.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se i pandehuri në fjalë dyshohet për veprë penale të cilat janë të natyrës mjaft të rëndë dhe parashihen dënime mjaft të larta, se i pandehuri S. T., është identifikuar dhe arrestuar pas identifikimit nga dëshmitarët, e duke marrë për bazë faktin se i pandehuri ka shtetësi të Serbisë, fakt ky i vërtetuar nga letërnjoftimi i tij me numër personal, dokument i lëshuar nga shteti i Republikës së Serbisë, si dhe deklarimi i vet të pandehurit në seancën dëgjimore në lidhje me shtetësinë e tij, prandaj me gjetjen e tij në liri, i njëjti do të mund arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale..

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.2. të KPP, sepse me gjetjen e të pandehurit në liri i njëjti mund të fsheh, ndryshojë, ose falsifikojë provat e veprës penale, si dhe të pengoj rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarët të cilët ende nuk janë dëgjuar e të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes, si dhe duke ndikuar në bashkëkryerësit tjerë, andaj këto rrethana arsyetojnë frikën se me lënien e të pandehurit në liri mund të vijë deri te pengimi i rrjedhës normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur për bazat ligjore për vazhdimin e paraburgimit dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.325/2023, më datë 12.07.2023

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetar i kolegjit,
Rasim Rasimi